
RRETH MANUALIT

Marrëveshjet gjatë përgatitjes së manualit:

1. Emrat e dritareve, skedave dhe butonave janë shënuar me shkrim të theksuar (bold).



Shembuj:

Hapet redaktuesi **Porosia**.
Hapet dritarja **Anulimi i porosisë**.
Klikoni skedën **Detajet**.
Klikoni butonin **Përzgjidh**.

2. Me shkronja të theksuara janë shënuar edhe emrat e menuve dhe metodave në shiritin e menusë. Gjithmonë, në rend të parë është emri i menusë, më pas emri i metodës. Me shkronja të theksuara janë shënuar edhe emrat e klasave.



Shembuj:

Përzgjidhni metodën **Porosia**.
Përzgjidhni metodën **Klasa / Objekti i ri**.

3. Me shkrim të theksuar dhe kursiv (italic) janë shënuar pjesët e tekstit, që kemi dashur t'i dallojmë nga pjesa tjetër e tekstit.



Shembull:

Destinacioni mund të jetë adresa elektronike ose printeri.

4. Ikonat janë paraqitur në mënyrë grafike.



Shembull:

Klikoni ikonën .

5. Emrat e attributeve, parametrave dhe listave janë vendosur në thonjëza.



Shembull:

Tek "Formati i rezultateve të kërkimit" përzgjidhni formatin, në të cilin dëshironi t'i shfaqni rezultatet e kërkimit.

6. Vlerat e attributeve janë shënuar me shkrim kursiv (italic).



Shembull:

Nëse porositësi dëshiron kopjen e artikullit, tek "Lloji i shërbimit" përzgjidhni vlerën *blerje*, tek "Lloji i materialit" vlerën *artikull* dhe tek "Mjedisi i materialit" vlerën *kopje*.

7. Tastet në tastierë janë vendosur brenda kllapave këndore.



Shembuj:

<Enter>, <Tab>, <Shift>, <Ctrl>, <Alt>, <Esc>.

8. Shenja plus (+) midis emrave të tasteve tregon se të dy tastet duhet t'i shtypni njëherësh.



Shembull:

<Ctrl> + <P> do të thotë se njëkohësisht duhet të shtypni tastin <Ctrl> dhe <P>. Shtypni tastin <Ctrl>, e mbani të shtypur dhe më pas shtypni edhe tastin <P>.